



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

MIRATUAR ME VENDIM TË AUTORITETIT NR.148, DATË 09.03.2026

**UDHËZUES
PËR QARTËSIMIN E FATIT TË PERSONAVE TË ZHDUKUR DHE TË EKZEKUTUAR
GJATË PERIUDHËS SË REGJIMIT KOMUNIST**

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, i ndryshuar, ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” (i ndryshuar), ligjit nr. 8480, datë 27.4.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, Ligjit nr. 124/2024, datë 19.12.2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, i ndryshuar Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të AIDSSH dhe akteve të tjera mbi funksionimin e strukturave të brendshme dhe administrimin e dokumentacionit,

VENDOSI:

**PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Ky udhëzues përcakton rregullat, procedurat dhe standardet administrative që ndiqen nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për trajtimin e kërkesave që lidhen me qartësimin e fatit të personave të zhdukur dhe të ekzekutuar gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri, me qëllim sqarimin e rrethanave reale të zhdukjes dhe/ose vdekjes së tyre, përcaktimin e vendndodhjes së mundshme të mbetjeve njerëzore si dhe dokumentimin institucional të përfundimeve. për qëllime të proceseve pasuese të identifikimit dhe rikuperimit, ky proces përfshin:

1. Sqarimin e rrethanave reale të zhdukjes dhe/ose vdekjes;
2. Përcaktimin e vendndodhjes së mundshme të mbetjeve njerëzore (kur ka indicie për një vendvarrim të dyshuar ose identifikuar);
3. Dokumentimin institucional për proceset pasuese të identifikimit dhe rikuperimit në rastet kur ka vendvarrime të identifikuara dhe të dyshuara.

Neni 2

Qëllimi

Ky Udhëzues ka për qëllim:

1. Garantimin e zbatimit korrekt të Ligjit nr. 45/2015, “*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*”, të ndryshuar, nëpërmjet përcaktimit të rregullave dhe të procedurave standarde që duhet të ndiqen për trajtimin e kërkesave për informim mbi qartësimin e fatit të personave të zhdukur dhe të ekzekutuar gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri;
2. Orientimin e veprimtarisë administrative të strukturës përgjegjëse Autoritetit, si dhe krijimi i bazës dokumentare që shërbejnë si pikënisje për proceset pasuese të bashkëpunimit në procesin e identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të personave të zhdukur;
3. Realizimin e së drejtës së personave të zhdukur, për familjarët e tyre dhe shoqërisë për t’u informuar.

Neni 3

Baza ligjore dhe metodologjike

Ky udhëzues bazohet në Ligjin nr. 45/2015 “*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*”, të ndryshuar, legjislacionin shqiptar për arkivat, Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të AIDSSH, si dhe akteve të tjera mbi funksionimin e strukturave të brendshme dhe administrimin e dokumentacionit.

Në zbatim të parimeve të së drejtës për të ditur të vërtetën dhe të standardeve ndërkombëtare mbi trajtimin e rasteve të zhdukjeve me forcë, në interpretimin dhe zbatimin e këtij udhëzuesi mbahen në konsideratë edhe aktet dhe standardet përkatëse ndërkombëtare, për aq sa nuk bien në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 4

Përkufizime

Për efekt të zbatimit të këtij udhëzuesi, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “Person i zhdukur” është personi i arrestuar, i burgosur, i rrëmbyer ose të cilit i është hequr liria në çdo formë tjetër nga agjentë të shtetit apo nga persona të tjerë a grupe personash, që kanë vepruar me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e shtetit, pasuar nga mohimi i pranimin të heqjes së lirisë ose nga fshehja e fatit të personit të zhdukur a e vendit ku gjendet ai, duke e shkëputur nga mbrojtja e ligjit.
2. “E drejta për informim” është e drejta e familjarëve dhe shoqërisë për të njohur fatin dhe rrethanat e zhdukjes dhe/ose vdekjes së personit të zhdukur.
3. “Aplikim për kërkimin dhe qartësimin e fatit të personave të zhdukur” është kërkesa me shkrim e paraqitur pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

(AIDSSH) nëpërmjet formularit të miratuar nga Autoriteti, ose aplikimi elektronik i kryer në faqen zyrtare të internetit (ëëë. te-zhdukurit/formular-aplikimi-per-informim-te-te-vdekurve-apo-te-te-zhdukurve/) nga:

- a. Familjarë dhe të afërm të personave të zhdukur
 - b. Persona fizikë vendas apo të huaj;
 - c. Persona pa shtetësi;
 - d. Si edhe përfaqësuesit e tyre ligjorë në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 45/2015, të ndryshuar.
4. “Kërkim dhe qartësim i fatit të personave të zhdukur” është procesi ligjor dhe administrativ që përfshin tërësinë e veprimeve për mbledhjen, verifikimin dhe analizimin e informacionit lidhur me personat e zhdukur. Ky proces realizohet përmes kërkimeve arkivore, mbledhjes së dëshmive nga familjarët ose persona të tjerë që kanë dijeni për rastin, bashkëpunimit ndërinstucional si dhe përmes vlerësimeve teknike e shkencore, me qëllim identifikimin e vendvarrimit dhe qartësimin e fatit të personave të zhdukur. Qartësimi i fatit synon :
- a. Përcaktimin e statusit të personit të zhdukur dhe, rrethanat reale të zhdukjes dhe vendndodhjen e zhdukjes (nëse është e mundur) dokumentimin institucional të përfundimeve të hetimeve administrative.
 - b. Identifikimin e rrethanave dhe ngjarjeve që lidhen me zhdukjen e personave gjatë periudhës së regjimit komunist.
 - c. Gjetjen dhe evidentimin e të dhënave mbi vendndodhjen e vendvarrimeve të personave të zhdukur ose të ekzekutuar.
 - d. Sigurimin e informacionit për personat fizikë, përfaqësuesit ligjorë, familjarët e afërm, si dhe subjektet e tjera të interesuara, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse (Neni 22 Ligji nr. 45/2015, i ndryshuar).
 - e. Koordinimin me institucionet shtetërore dhe ndërkombëtare për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e hulumtimeve dhe rikuperimin e mbetjeve mortore, si dhe ruajtjen e vendvarrimeve (Neni 22/1 Ligji nr. 45/2015, i ndryshuar).
 - f. Garantimin e trajtimit të kërkesave brenda parimeve të ligjshmërisë, transparencës, paanshmërisë, mbrojtjes së të dhënave personale dhe interesit publik.
5. “Trajtimi i kërkesës” është tërësia e veprimeve administrative dhe bashkërendimi institucional që garantojnë:
- a. Administrimin e kërkesave individuale për kërkimin dhe qartësimin e fatit të personave të zhdukur;
 - b. bashkërendimin ndërmjet strukturave të brendshme të AIDSSH-së dhe institucioneve të tjera shtetërore e ndërkombëtare;
 - c. realizimin e procesit të identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të personave të zhdukur dhe të ekzekutuar gjatë regjimit komunist;
 - d. përgatitjen dhe dërgimin e përgjigjeve me shkrim për subjektet kërkuese. Në këtë kuadër, ndër institucionet bashkëpunuese përfshihen, por pa u kufizuar në:
 - ✓ Ministrinë e Brendshme,
 - ✓ Ministrinë e Mbrojtjes,
 - ✓ Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave
 - ✓ Institucionet Vendore
6. “Kërkues” ka të njëjtin kuptim si në përkufizimet e Ligjit nr. 45/2015, të ndryshuar, dhe përfshin:
- a. “Të afërmin”, sipas përkufizimit të pikës 1 të nenit 22 të Ligjit nr. 45/2015, të ndryshuar;

- b. “Palën e tretë”, sipas përkufizimit të pikës 10 të nenit 3 të Ligjit nr. 45/2015, të ndryshuar.
- 7. “Rrethanat reale të vdekjes apo zhdukjes së personit/ave” janë ato rrethana faktike që përfshijnë, ndër të tjera:
 - a. Vdekjen e personit në ambiente ndalimi apo vuajtjeje dënimi, e paraqitur si vdekje natyrale ose për shkaqe shëndetësore, ndërkohë që është shkaktuar në mënyrë të stimuluar dhe shpesh shoqëruar me zhdukjen e trupit;
 - b. Ekzekutimin e personit të dënuar me vdekje në rrethana të tjera nga ato të deklaruar zyrtarisht, duke mos bërë të ditur vendndodhjen e trupit;
 - c. Vrasjen e inskenuar si vetëvrasje apo aksident, e kryer përmes metodave të presionit psikologjik dhe mjeteve të posaçme të përdorura nga organet e Sigurimit të Shtetit;
 - d. Vdekjen në kushte spitalore të dyshimta, me dokumentacion mjekësor të manipuluar ose të munguar dhe mungesë autopsie transparente, shoqëruar me mospërbushjen e detyrimit për dorëzimin e trupit familjarëve;
 - e. Rastet kur personi është shpallur si i arratisur, ndërkohë që është rrëmbyer, ekzekutuar dhe zhdukur, ose është zhdukur gjatë ose pas përfshirjes në veprimtari të fshehta me ose pa detyrim.
- 8. “Status administrativ” i personit është kategorizimi i personit, pas përfundimit të procesit të qartësimit të fatit, si person i zhdukur me prezumim vdekjeje, i ekzekutuar me vendim gjykate/organet kompetente, person i ekzekutuar, person i vdekur.
- 9. “Vendvarrim i dyshuar” është çdo vendndodhje e identifikuar në bazë dokumentesh, dëshmish ose të dhënave të besueshme, ku dyshohet se ndodhen eshtrat e personave të zhdukur.
- 10. “Regjistri Kombëtar i Personave të Zhdukur” përfshin bazën e të dhënave administrative të Autoritetit ku regjistrohen të dhënat e personave të zhdukur sipas fushave të përcaktuara, në përputhje me standartet ndërkombëtare.
- 11. “Databaza e gjurmueshmërisë së vendvarrimeve” është sistemi i regjistrimit dhe menaxhimit të të dhënave mbi vendvarrimet e dyshuara dhe të identifikuara.

PJESA II

PARIMET UDHËHEQËSE

Neni 5

Parimet

Procesi i qartësimit të fatit udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- 1. I së drejtës për kërkimin e së vërtetës: Familjarët dhe shoqëria kanë të drejtën e patjetërsueshme për t'u njohur me rrethanat e vdekjes dhe vendndodhjen e personit.
- 2. Dinjitetit njerëzor: Trajtimi me respekt i mbetjeve mortore dhe i kujtimit të personit të zhdukur, viktimë e regjimit komunit.
- 3. Mosdiskriminimi: Garantimi i procesit pa asnjë dallim të bazuar në bindjet politike, origjinën etnike, besimin fetar apo statusin social të personit të zhdukur.

4. Objektiviteti dhe saktësia shkencore: Bazimi i procesit në prova dokumentare dhe raporte teknike të certifikuara.
5. Konfidencialiteti dhe integriteti: Ruajtja e të dhënave personale dhe mbrojtja e integritetit të procesit të kërkimit.
6. Pavarësia administrative dhe bashkëpunimi ndërinstitucional: Koordinimi i detyrueshëm mes strukturave shtetërore duke ruajtur paanshmërinë e Autoritetit.

PJESA III

PROCEDURA ADMINISTRATIVE

Neni 6

Nisja e Procedurës

Procedura për qartësimin e fatit të personit të zhdukur, nis me kërkesë të familjarëve ose subjekteve të legjitimuar, kryesisht nga Autoriteti, ose mbi bazën e informacioneve të reja të besueshme. Çdo subjekt që përfshihet në kategorizimet e mëposhtme në kuptim të përkufizimeve të Ligjit 45/2015, i ndryshuar mund të paraqesë një kërkesë për kërkimin dhe qartësimin e fatit të personave të zhdukur:

- a. Të afërmve apo familjarëve të të vdekurve apo të zhdukurve, i cili trajtohet në kuptim të nenit 22 të Ligjit 45/20105, i ndryshuar;
- b. Përfaqësuesit ligjorë me prokurë nga personat të cilët gëzojnë cilësinë e të të afërmit apo familjarit të të vdekurit apo të zhdukurit;
- c. Palët e treta të cilët kanë njohuri për fatin e personave të zhdukur.

Neni 7

Forma e Kërkesës

Kërkesa për qartësimin e fatit paraqitet nëpërmjet formularit tip të miratuar me vendim të Organit Kolegjial të Autoritetit me Nr.356, datë 17/07/2025.

Kërkesat e paraqitura jashtë formularit administrohen, duke udhëzuar kërkuesit për plotësimin e formularit të miratuar nga Autoriteti (Formulari tip i Aplikimit për Kërkimin dhe Qartësimin e Fatit të Personave të Zhdukur Bashkëlidhur ketij Udhezuesi)

Neni 8

Dëshmitë e Familjarëve

Dëshmitë e familjarëve dhe të afërmve merren sipas modelit standard të deklaramentit, të miratuar me vendim të Organit Kolegjial. Dëshmitë kanë karakter informues dhe administrativ.

Neni 9

Kërkimi i informacionit

Autoriteti ushtron kërkim të strukturuar të informacionit në arkivën e vet, në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, në regjistrat e gjendjes civile, në shërbimet funerale dhe administrimin e varrezave, si dhe në burime të tjera të ligjshme institucionale.

1. Ky proces përfshin gjithashtu mbledhjen e dëshmive të familjarëve ose palëve të treta, si dhe administrimin e dëshmive teknike administrative.
2. Dëshmitë teknike administrative shërbejnë si bazë dokumentare për orientimin e hetimit administrativ. Identifikimi i anomalive përmes vlerësimeve tekniko shkencore nuk konfirmon automatikisht praninë e mbetjeve njerëzore, por shërben si provë teknike për të përcaktuar nevojën e ndërhyrjeve pasuese për identifikimin e vendvarrimit dhe planifikimin e proceseve të rikuperimit.

Neni 10

Provat Teknike/shkencore Administrative

1. Provat teknike administrative janë dokumente zyrtare që përmbajnë të dhënat e gjeneruara nga vlerësimet teknike shkencore (si GPR, magnetometria, skanimi lazer, dron etj.) mbi vendvarrimet e dyshuara, me qëllim lokalizimin e mbetjeve njerëzore pa ndërhyrje fizike në terren.
2. Autoriteti, për realizimin e vlerësimeve tekniko shkencore, siguron kryerjen e këtij shërbimi përmes angazhimit të palëve të treta të specializuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Palët e treta mund të jenë universitete ose qendra kërkimore, institucione shtetërore vendase apo të huaja me ekspertizë specifike, si dhe kompani konsulence të specializuara në fushat e gjeofizikës, arkeologjisë apo inxhinierisë.
3. Përmbajtja e provës teknike. Çdo vlerësim tekniko shkencor prodhon një raport që duhet të përfshijë:
 - a. Radargramet dhe hartat e anomalive: Imazhet e përftuara nga skanimi që tregojnë ndryshimet në dendësinë e nëntokës (dheu i trazuar ose struktura të dyshimta).
 - b. Koordinatat Gjeohapësinore (GIS): Pozicionimi i saktë satelitor i perimetrit të vendvarrimit të dyshuar.
4. Këto prova përbëjnë bazën dokumentare për ndryshimin e statusit të personit në Regjistrin Kombëtar të Personave të Zhdukur.
5. Rezultatet e këtyre vlerësimeve, shërbejnë për të orientuar vlerësimin e Autoritetit mbi identifikimin e vendvarrimeve dhe për vendimmarrjen për shpalljen e tyre si "vendvarrim i dyshuar" në mbrojtje.

PJESA IV

MENAXHIMI I TË DHËNAVE

Neni 11

Regjistri i Personave të Zhdukur

Të dhënat për personat e zhdukur regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Personave të Zhdukur sipas fushave të përcaktuara në IDMS (Sitemit të Integruar të Manaxhimit të të Dhënave) dhe përditësohen

në përputhje me legjislacionin Shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale: Ligji 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”

Neni 12

Verifikimi dhe Gjurmueshmëria e Vendvarrimeve të Dyshuara

Të dhënat mbi vendvarrimet e dyshuara regjistrohen në databazën e gjurmueshmërisë së vendvarrimeve, për qëllime dokumentimi dhe orientimi të procesit të kërkimit.

- Të dhënat mbi vendvarrimet e dyshuara regjistrohen në Databazën e Gjurmueshmërisë së Vendvarrimeve me qëllim dokumentimin, monitorimin dhe orientimin e saktë të procesit të kërkimit.
- Ekspertët dhe Verifikimi Teknik: Procesi i verifikimit kryhet nga një grup ekspertësh multidisiplinarë (arkeologë forenzikë, gjeofizikanë, analistë të të dhënave). Verifikimi teknik përfshin vlerësimin e dëshmimeve teknike administrative të gjeneruara nga metodat tekniko shkencore, për të vërtetuar nëse indiciet e mbledhura përkojnë me karakteristikat fizike të një vendvarrimi.
- Kategorizimi i Anomalive: Anomalitë e identifikuar gjatë verifikimit teknik kategorizohen sipas shkallës së probabilitetit:
 - Kategoria 1 (Besueshmëri e lartë): Anomali që përkojnë me përmasat dhe formën e mbetjeve njerëzore/arkivolëve, të mbështetura nga dëshmi arkivore.
 - Kategoria 2 (Besueshmëri mesatare): Ndryshime të strukturuar të nëntokës (dhe i trazuar) që kërkojnë hetim shtesë administrativ.
 - Kategoria 3 (Besueshmëri e ulët): Anomali që mund të jenë me origjinë natyrore ose mbetje teknologjike, por që kërkojnë monitorim.
- Koordinatat dhe Integriteti i të Dhënave: Çdo vendvarrim i identifikuar ose i dyshuar pajiset me koordinata gjeohapësinore (GIS) unike dhe të sakta (sistemi GPS/RTK). Integriteti i të dhënave garantohehet përmes dokumentimit të pandryshueshëm të vlerësimeve fillestare (*raw data*) dhe ruajtjes së zinxhirit të komandës mbi informacionin e mbledhur.
- Konfidencialiteti dhe Siguria: Koordinatat e sakta dhe raportet teknike mbi vendvarrimet e identifikuar kanë karakter rreptësisht konfidencial. Aksesit në këto të dhëna kufizohet vetëm për personelin e autorizuar, me qëllim parandalimin e ndërhyrjeve të paautorizuara, dëmtimit të provave apo cenimit të dinjitetit të viktimave përpara procesit të rikuperimit.
- Gjurmueshmëria: Databaza duhet të pasqyrojë historikun e plotë të vendvarrimit, që nga regjistrimi i indicies së parë, rezultatet e vlerësimeve teknike, e deri te vendimmarrja administrative për hapat pasues (gërmim ose ruajtje).

PJESA V

AKTI I QARTËSIMIT TË FATIT

Neni 13

Akti administrativ

Në përfundim të procedurës administrative për qartësimin e fatit të personit të zhdukur, Autoriteti nxjerr aktin administrativ të miratuar me vendimin e Organit Kolegjial, i cili përmban përshkrimin e rastit, burimet e përdorura dhe përfundimin mbi statusin e personit të zhdukur:

1. Detajet e identifikimit të personit dhe rrethanat specifike të vdekjes së tij.
2. Dokumentacionin arkivor, dëshmitë, si dhe raportin teknik të vrojtimit tekniko shkencor të terrenit, sipas kritereve të verifikimit teknik të përcaktuara në Nenin 12 të këtij udhëzuesi.
3. Deklarimin e faktit të vdekjes dhe, në rastet kur ka indicie për vendvarrime të dyshuara, përcaktimin e kategorisë së anomalisë (sipas pikës 3 të Nenit 12) dhe zonën specifike ku mendohet se gjenden mbetjet mortore, të shoqëruar me koordinatat gjeohapësinore (GIS) unike të gjeneruara nga sistemi.
4. Referencën e regjistrimit të rastit në sistemin iDMS dhe në Databazën e Gjurmueshmërisë së Vendvarrimeve, duke garantuar përputhshmërinë e historikut të të dhënave nga indicia fillestare deri në aktin final.
5. Ky akt administrativ miratohet me Vendim të Organit Kolegjial të Autoritetit dhe i përcillet për njohje, zbatim dhe ndjekje institucioneve qendrore dhe vendore të përfshira në proces.¹

PJESA VI

AFATET KOHORE PROCEDURALE TË TRAJTIMIT DHE ANKIMIMIT NDAJ VENDIMMARRJES SË AUTORITETIT

Neni 14

Afatet Kohore të Trajtimit të Kërkesave

1. Për shqyrtimin e kërkesave, procedura për përmbylljen e praktikës së krijuar duke përfshirë dhe vendimmarrjen e Autoritetit, të kryhet brenda afatit kohor prej 6 (gjashtë) muaj kalendarikë, si dhe brenda afatit kohore prej 45 ditë pune për kërkesat që nuk identifikohen dokumente arkivore.
2. Në rastet kur për shkak të mangësive, volumit, kompleksitetit të dokumenteve, afati 6 muajor i përcaktuar në neni 38, pika 4 të Rregullores nr. 92 datë 12.02.2024, mund të zgjatet pasi të vlerësohet nga Autoriteti.

PJESA VII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky udhëzues hyn në fuqi pas miratimit nga Organi Kolegjial i Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

¹ Ligji 45/2015 i Ndryshuar. Neni 22/2